



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:029042

Datë: 08.04.2024

Numri i dokumentit: 05557351

KA.nr.1085/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Ardi” Sh.P.K, me seli në Prishtinë, Zona Industriale, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCRL Partners” Sh.P.K, me seli Prishtinë, Soliteri Avalla P+12, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit PSH.nr. 729-738/2021 të datës 28.07.2022, pa shqyrtim kryesor të mbajtur, me datë 08.04.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Ardi” Sh.P.K. kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit.
- II. ANULOHET vendimi i të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit, PSH.nr.729-738/2021 i datës 28.07.2022, dhe çështja i kthehet të paditurit në rishqyrtim dhe rivendosje.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “Ardi” Sh.P.K., ka parashtruar padi kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) për shkak të heshtjes administrative lidhur me ankesën e datës 11.10.2021 dhe kërkesës së përsëritur për vendosje sipas ankesës së datës 15.10.2021 të parashtruar me datë 17.01.2022 përmes email nga paditësi. Me parashtrësë të datës 31.08.2022 ka bërë precizimin e padisë ku ka kërkuar anulimin e Vendimit PSH.nr. 729-738/2021 të datës 28.07.2022 me të cilin i padituri kishte hedhur si të jashtë afatshme për shqyrtim ankesën e paditësit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material medicinal nga lista esenciale për SHSKUK për Lot 1, 2 dhe 3” me nr. të prokurimit 00220-21-5574-1-1-1 i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –

Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës. I njëjti ka theksuar se pretendimi i të paditurit se kanë kaluar afatet ligjore që OSHP të shqyrtojë ankesën e paditësit është i pabazuar pasi që aktiviteti i prokurimit i cekur më lartë është pezulluar sipas ankesës që ka parashtruar paditësi ndaj vendimit të AK-së ndërsa shton se i padituri nuk ka arsyetuar shkaqet përfundimtare pse shqyrtimi i ankesës së paditësit është i pamundur dhe aktiviteti i prokurimit të cekur më lartë është bërë i kotë. Tutje ka shtuar se asnjë ligj nuk e parashihet se organi administrativ ka të drejtë të hedhë si të jashtë afatshme për shqyrtim ankesën për të cilën organi i administratës nuk ka vendosur brenda afatit ligjor, andaj shton se i padituri ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Po ashtu ka theksuar se vendimi i AK-së me të cilin ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të paditësit është përcjellur me shkelje të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Ligjit për Prokurimin Publik duke mos marrë parasysh pretendimet e paditësit dhe provat e paraqitura. Lidhur me Lot 1 ka shtuar se AK ka eliminuar paditësin me arsyetimin se i njëjti ka shënuar dy numra pas presës dhjetore në përshkrimin e ofertës dhe z. A.Z. nuk ka qenë i autorizuar për nënshkrimin e ofertës dhe deklaratës nën betim, duke pretenduar se në këtë rast AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik pasi që paditësi për këtë Lot ka ofertuar çmim pa fitim dhe ka qenë ofertuesi ma i lirë ndërsa pretendon se i padituri ka vepruar në kundërshtim me nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik sepse sipas këtij neni AK ka mundur të ftojë paditësin që të plotësoj dokumentacionin me autorizim për z. A.Z.. Paditësi thekson se nuk qëndrojnë pretendimet e AK se “Ardi” Sh.P.K. nuk ka plotësuar kërkesat nr. 5 dhe 6 të dosjes së tenderit sepse për kërkesën nr. 5 AK në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar nuk ka cekur se për cilin Lot nuk ka plotësuar këtë kërkesë duke shtuar se paditësi në listën e kontratave dhe referencave për tre vitet e shkuara paraqiten shuma të cilat tejkalojnë vlerën për Lot 1, 2 dhe 3, ndërsa për kërkesën nr. 6 për Lot 3 paditësi ka theksuar se ka dorëzuar mostrën e produktit dhe paketimin që përmban etiketën e numrit serik, datën e prodhimit, datën e skadimit të cilat janë edhe në paketimin e importit. Lidhur me Lot 2 paditësi ka pretenduar se operatori ekonomik “Agani” LTD nuk ka plotësuar kushtet e kërkuara pasi që produkti dorëza nuk plotësojnë standardet e Bashkimit Evropian, ka dorëzuar dy certifikata të dy prodhuesve të ndryshëm për Lot 2 dhe ka paraqitur dokumente të rrejshme lidhur me prodhimin e produkteve të dorezave. Lidhur me Lot 3 paditësi ka pretenduar se operatori ekonomik “Made – Kos” Sh.P.K. ka paraqitur etiketë të bërë nga OE “Made – Kos” Sh.P.K. për afatin e kalimit të produkteve që paraqesin kalim të afatit të produkteve pas 5 viteve ndërsa paditësi ka konstatuar se pas komunikimit përmes email me kompaninë e prodhimit “Podima Medikal” këto produkte kanë afat vetëm 3 vite. Paditësi po ashtu pretendon se AK për aktivitetin e prokurimit të cekur më

lartë, në të gjitha Lotet i ka dhënë kontratë operatorëve ekonomik të papërgjegjshëm dhe të cilët kanë ofruar çmim më të lartë se paditësi. Gjykatës i ka propozuar që duke marrë parasysh pretendimet e paraqitura si më lartë ta aprovoj padinë e paditësit si të bazuar dhe ta anuloj Vendimin PSH.nr. 729-738/2021 të datës 28.07.2022 dhe lëndën ta kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje pranë të paditurit.

I padituri në përgjigje në padi ka kontestuar në tërësi padinë e paditësit duke theksuar se OSHP pas pranimit të ankesës nga paditësi kishte angazhuar ekspertin shqyrtues lidhur me shqyrtimin e ankesës së paditësit dhe sipas raportit të ekspertizës i kishte rekomanduar OSHP-së që të aprovojë ankesën e paditësit pjesërisht si të bazuar, të anulojë vendimin e AK-së për Lot 2 ndërsa të mbetet në fuqi vendimi i AK-së për Lot 1 dhe Lot 3, kështu që lënda të kthehet në rivlerësim, mirëpo Paneli Shqyrtues i OSHP-së ka hedhur si të jashtë afatshme për shqyrtim ankesën e paditësit me arsyetimin OSHP nuk ka pasur mundësi të krijoj panel shqyrtues për marrjen e vendimit përfundimtar sepse OSHP gjatë kësaj periudhe ka funksionuar pa Bord ndërsa pas krijimit të Bordit të OSHP-së, i njëjti ka vendosur se ankesat e parashtruara para krijimit të tij nuk mund të shqyrtohen pasi që se ka kaluar afati ligjor për shqyrtimin e ankesave sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe qëllimi i shqyrtimit të ankesave është bërë i pamundur dhe i kotë. Gjykatës i ka kërkuar që të konstatoj se nuk janë përmbushur shkaqet për goditje të aktit administrativ sipas nenit 16 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konflikte Administrative dhe ka propozuar që ta refuzojë padinë e paditësit si të pabazuar dhe ta lë në fuqi Vendimin PSH.nr. 729-738/21 të datës 28.07.2022.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, nga shkresat e lëndës ka administruar këto prova: Ankesë e datës 11.10.2021, komunikim përmes email i datës 17.01.2022 dhe 21.01.2022, Vendim PSH.nr.729-738/2021 i datës 28.07.2022, Dosja e tenderit e “Ardi” Sh.P.K. me dokumentet e bashkangjitura, autorizim i prodhuesit i datës 28.08.2021, autorizim i prodhuesit i datës 01.09.2021.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me 35 të LKA-së, provave të administruara, thënieve në padi dhe përgjigjen në padi të së paditurit si dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.

Gjykata konstatoi se me Vendimin kontestues PSH.nr.729-738/2021, Bordi i Organit Shqyrtues të Prokurimit në pikën I të diapozitivit ka hedhur si të jashtë afatshme për shqyrtim ankesën e operatorit ekonomik “Ardi” Sh.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material medicinal nga lista esenciale për SHSKUK për Lot 1, 2 dhe 3” me nr. të prokurimit 00220-21-

5574-1-1-1, për Lot 2, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 99 par. 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik i cili përcakton se: *“3. Të gjitha vendimet e nxjerra nga OSHP mund të shqyrtohen nga Gjykata kompetente në pajtim me ligjin për shqyrtimin gjyqësor të çështjeve administrative”* në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se: *“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.”* dhe në kuptim të nenit 35 të LKA-së i cili përcakton se: *“Nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë në bazë të paragrafit 2. të nenit 33, apo në bazë të nenit 34 të këtij ligji, kurse konstaton se akti administrativ i kontestuar përmban të meta esenciale, që e pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së aktit, e anulon me aktgjykim, aktin administrativ edhe pa e dërguar padinë në përgjigje.”*

Gjykata i vlerësoi të bazuara pretendimet e paditësit pasi që i padituri nuk i ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore, duke mos i administruar dhe shqyrtuar provat për vërtetimin e gjendjes së saktë faktike, lidhur me shqyrtimin e ankesave në bazë të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Gjykata, nga provat e administruara në këtë çështje të konfliktit administrativ ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Nga ankesë e datës 11.10.2021, gjykata ka konstatuar se paditësi me datë 11.10.2021 ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së kundër vendimit për refuzim të kërkesave për rishqyrtim të pabazuara e datës 07.10.2021 të dhënë nga AK – Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material medicinal nga lista esenciale për SHSKUK për Lot 1, 2 dhe 3” me nr. të prokurimit 00220-21-5574-1-1-1 për Lot 1, 2 dhe 3.

Nga komunikim përmes email i datës 17.01.2022 dhe 21.01.2022, gjykata ka konstatuar se paditësi me datë 17.01.2022 përmes email ka parashtruar kërkesë me titull “Kërkesë e përsëritur për vendosje e datës 17.01.2022 sipas ankesës së datës 15.10.2021” lidhur me vendosjen për ankesën që paditësi e ka parashtruar me datë 15.10.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material medicinal nga lista esenciale për SHSKUK për Lot 1, 2 dhe 3” me nr. të

prokurimit 00220-21-5574-1-1-1. Gjithashtu me datë 21.01.2022 paditësi përmes email ka bashkangjitur kërkesën në formë dokumenti.

Nga Dosja e Tenderit e “Ardi” Sh.P.K. me dokumentet e bashkangjitura, gjykata ka konstatuar se dosja e tenderit të paditësit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material medicinal nga lista esenciale për SHSKUK për Lot 1, 2 dhe 3” me nr. të prokurimit 00220-21-5574-1-1-1 përmban: Kontratë pune të lidhur mes “Ardi” Sh.P.K. dhe A.Z. që vlenë nga 01.11.2020 deri me 31.10.2023; Autorizim gjeneral i dhënë nga paditësi për të punësuarin A.Z. për të ndërmarrë veprime juridike – procedurale në emër të paditësit pranë të gjitha organeve shtetërore në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe të ketë mundësinë e nënshkrimit të kontratave dhe dokumenteve të tjera në procedura tenderuese; Të dhëna nga pasqyra e llogarisë për periudhat 01.11.2020 – 30.09.2021 për A.Z.; Lista e kontratave të realizuara nga paditësi dhe kompani të tjera përgjatë periudhës 12.07.2018 – 22.06.2021; Kontratë publike e lidhur mes AK - Ministrisë së Infrastrukturës dhe paditësit me datë 01.04.2021 për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material mbrojtës për Covid 19” me nr. 205-20-8545-1-2-1 e nënshkruar për paditësin nga z. A.Z.. Draftë kontratë publike kornizë e përpiluar me datë 09.02.2021 nga AK – Komuna e Lipjanit dhe Grupi i OE “Iris Pharma” Sh.P.K. dhe “Ardi” Sh.P.K. për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me dezinfektues 500ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshme për të gjitha institucionet edukativo – arsimore” me nr. të prokurimit 613-20-5228-1-2-1; Formularët e dorëzimit të tenderit të plotësuar nga paditësi për aktivitetin e prokurimit të cekur më lartë për Lot 1 me çmim të ofertuar në vlerë prej 52,000.00€, për Lot 2 me çmim të ofertuar në vlerë prej 343,040,00€, për Lot 3 me çmim të ofertuar në vlerë prej 499,520,00€; Raporti nga testet për maska i dhënë nga Befitlab test technology Shanghai Co. Ltd për prodhuesin Changzhou Kangfulai Medical Thing Co. Ltd. Referencë e dhënë nga Med Group L.L.C, referencë e dhënë nga OJQ Communication for Social Development, referencë e dhënë OJQ Mreza Za Gradanski Aktivizam - Mga, referencë e dhënë nga OJQ GYI, referencë e dhënë nga N.T.SH Koslabor, referencë e dhënë nga Klinika Amerikane Sh.P.K., referencë e dhënë nga Drejtoria e Prokurimit në Lipjan për paditësin me datë 01.09.2021, referencë e dhënë nga Iris Pharma Sh.P.K., referencë e dhënë nga Forma Sh.P.K. referencë e dhënë nga Infinitt Sh.P.K.

Nga autorizim i prodhuesit i datës 28.08.2021. gjykata ka konstatuar se Changzhou Lamgfulai Medical Thing Co., Ltd me datë 28.08.2021 ka dhënë autorizim si prodhues për paditësin për furnizim me produkte medicinale lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material mbrojtës për Covid 19” me nr. 205-20-8545-1-2-1 për Lot 1.

Nga autorizim i prodhuesit i datës 01.09.2021, gjykata ka konstatuar se Top Glove SDN.BHD. ka me datë 01.09.2021 ka dhënë autorizim si prodhues për furnizim me produkte medicinale për paditësin lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material mbrojtës për Covid 19” me nr. 205-20-8545-1-2-1 për Lot 2.

Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri në procedurë administrative ka zbatuar gabimisht dispozitat procedurale, përkatësisht nuk ka aplikuar drejtë nenin 104 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Gjykata vlerëson se për aplikimin e nenit 104 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i padituri, duhet që i padituri të bëjë vlerësimin nëse qëllimi i vazhdimit të procedurës është i kotë dhe i pamundur në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues dhe Operatorët Ekonomik. Prandaj, gjykata ka konstatuar se i padituri nuk ka pasur bazë ligjore për hedhje si të jashtë afatshme të ankesës së paditësit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material mbrojtës për Covid 19” me nr. 205-20-8545-1-2-1 pasi që ndryshimi i Bordit të paditurit nuk e bën të pamundshëm qëllimin e kësaj procedure.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret i padituri gabimisht ka konstatuar shkelje të nenit 114, 115 dhe 117 të Ligjit për Prokurimin Publik pasi që nga provat e administruara i padituri nuk ka arritur të dëshmojë se ka zbatuar procedurat e shqyrtimit të mjetit juridik konform LPP-së.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 99 par.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (LPP) i cili përcakton se: *“1. OSHP është përgjegjëse për zbatimin e procedurave për shqyrtimin e prokurimit sipas Pjesës IX të këtij ligji dhe kanë autoritetin dhe përgjegjësitë e parashikuara në atë Pjesë”* dhe nenit 52 par. 1 pika 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *“1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:” “1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;”*.

Gjykata vlerëson se hedhja e ankesës si jashtë afatit për shqyrtim nga i padituri nuk gjenë bazë ligjore dhe përbën shmangie të kompetencave dhe përgjegjësiqe që i padituri i ka të përcaktuara me ligj. Një shmangie e tillë e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësiqe nuk është e lejuar me ligj, andaj vendimi i nxjerrë nga i padituri në kuptim të nenit 52 të LPPA-së është i paligjshëm pasi që është nxjerrë si rezultat i shkeljes së dispozitave lidhur me shqyrtimin e ankesave nga i padituri si organ i shkallës së dytë.

Gjykata po ashtu vlerëson se i padituri me rastin e nxjerrjes së vendimit kontestues, nuk ka arritur që të ndërtojë strukturën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar, siç është përcaktuar me nenin 47 par. 1 nën par. 2 të LPPA-së i cili përcakton se: *“1. Akti administrativ i shkruar përmban: ... 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit.”* dhe nenin 48 par. 1 të LPPA-së i cili përcakton se *“1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.”*

Sipas vlerësimit të gjykatës, vendimi i të paditurit është në kundërshtim me dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë përmbajtjen e aktit administrativ, kjo për faktin se arsyetimi i vendimit nuk përmban bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret, përkatësisht nuk përmban bazë ligjore që i padituri ka pasur kompetencë për mos trajtimin në mënyrë meritore të ankesës së paditësit.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi mbështetur në nenin 43 par. 2 të LKA-së që përcakton se: *“Nëse gjykata konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, e që nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, ose konstaton se në procedurën administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, gjykata do të anulojë me aktgjykim aktin e kontestuar administrativ. Në një rast të tillë, organi kompetent ka për detyrë të veprojë ashtu si është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerrë akt të ri administrativ.”*, ashtu që duke qenë se në rastin konkret nuk ka pasur bazë ligjore për hedhjen e ankesës së paditësit, gjykata anuloi vendimin kontestues të nxjerrë nga i padituri në procedurë administrative dhe çështjen e ktheu në rishqyrtim dhe rivendosje.

Në këtë drejtim, gjykata e obligon organin e paditur, në kuptim të nenit 65 të Ligjit për Konflike Administrative, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri procedurë të veprj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe t'i mënjanoj të metat lidhur me vendimin kontestues ashtu që të trajtojë ankesën e paditësit në mënyrë meritore dhe të shqyrtojë pretendimet e paraqitura në ankesë lidhur me vendimin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material medicinal nga lista esenciale për SHSKUK për LOT 1, 2 dhe 3" me numër të prokurimit 00220-21-5574-1-1-1.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 64 të Ligjit për konfliktet Administrative, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr. 1085/22, datë 08.04.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.